

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

MINISTRIA E INDUSTRIË

DHE ENERGJITIKËS

Nr. 66 Prot. Datë 31 03. 2005

Nr. 1588 / Prot. Datë 30 03. 2005

**UDHËZIM
I
PËRBASHKËT**

PËR FUNKSIONIMIN E POLICISË GJYQËSORE NË POLICINË ELEKTRIKE

Me synim, organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore në Policinë Elektrike,

Në mbështetje, të nenit 30 e vijues të K. Pr, Penale, të nenit 17, 5/2, 8 e vijues të ligjit nr. 8677 datë 02.1.2000 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Policisë Gjyqësore", dhe të ligjit nr. 8637 datë 06.07. 2000 "Për Policinë Elektrike", ndryshuar me ligjin Nr. 9170 datë 22. 01.2004,

UDHËZIJMË:

1. Policia gjyqësore në Policinë Elektrike e përbërë nga oficerët dhe agjentët e saj, organizohet dhe funksionon:

.1.1. në Shërbimet e Policisë Gjyqësore në strukturat e Drejtorisë së Policisë Elektrike dhe degët e saj në prefektura, si dhe;

.1.2. në Seksionet e Policisë Gjyqësore në Prokuroritë e rretheve gjyqësore.

2. Veprimtaria procedurale penale e oficerëve dhe agjentëve të policisë gjyqësore në Policinë Elektrike realizohet nën drejtimin, kontrollin, urdhrat dhe udhëzimet e prokurorit që ka në kompetencë lëndore dhe tokësore të ndjek procedimin, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore të Policisë Elektrike për të dhënat dhe ecurinë e hetimit përgjigjen dhe raportojnë vetëm tek prokurori përkatës.

3. Drejtuesit e Policisë Elektrike duhet të marrin të gjitha masat për të realizuar në veprimtarinë praktike të vartësisë funksionale nga prokurori, të oficerëve dhe agjentëve të tyre.

4. Oficerët e policisë gjyqësore të Policisë Elektrike të caktuar në Seksionin e Prokurorisë, nuk mund të ngarkohen me detyra të tjera që nuk kanë lidhje me veprimtarinë e policisë gjyqësore, përveç rasteve të urgjencës ose të stërvitjes, për të cilat njoftohet dhe merret pëlqimi i drejtuesit të Prokurorisë përkatëse.

1. Oficeret dhe agjentët e Policisë Gjyqësore në Policinë Elektrike kanë për detyrë të marrin dijeni për vepra penale që lidhen me administrimin dhe përdorimin e energjisë elektrike në sektorin shtetëror dhe privat, vendas ose të huaj, të pengojnë ardhjen e pasojave të mëtejshme, të kërkojnë dhe zbulojnë autorët e veprave penale në këtë fushë, të kryejnë" hetime paraprake me iniciativë ose me urdher apo delegim të prokurorit, të grumbullojnë gjithçka që i shërben zbatimit të ligjit penal, si dhe të kryejnë detyra të tjera të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

2. Policia gjyqësore e Policisë Elektrike kryen veprimtarinë" e saj në përputhje me juridiksionin dhe kompetencën lëndore dhe tokësore të përcaktuara në ligjin nr. 8637 datë 6. 07, 2000 "Për Policinë Elektrike", ndryshuar me ligjin Nr. 9170 datë 22. 01.2004.

2.1 Shërbimet e policisë gjyqësore në Drejtorinë e Policisë Elektrike ushtrojnë funksionet e Policisë Gjyqësore sipas kompetencës lëndore në të gjithë territorin e vendit.

2.2 Shërbimet e policisë gjyqësore në Policinë Elektrike në veprimtarinë e tyre ruajnë hierarkinë sipas ndërtimit administrativ të strukturave të tyre.

5. Oficeri drejtues i Shërbimeve të Policisë* Gjyqësore në Policinë Elektrike për veprimtarinë e oficerëve dhe agentëve që varen prej tij, përgjigjet para prokurorit që drejton hetimin lidhur me zbatimin e detyrave të parashikuara në K, Pr. Penale dhe në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore".

5.1 Krahas prokurorit, ata përgjigjen edhe para eprorëve të tyre, për organizimin administrativ të punës së oficerëve dhe agentëve që kryejnë detyrat e policisë gjyqësore, për administrimin e proceseve hetimore, për ruajtjen e sekretit të hetimit, për zbatimin e hetimeve paraprake, për zbulimin dhe dokumentimin e veprimtarisë kriminale në përputhje me kërkesat e K. Pr. Penale.

6. Për ngjarjet kriminale në juridiksion të Policisë Elektrike njoftohet menjëherë drejtuesi i Prokurorisë së rrethit gjyqësor përkatës ose prokurori i gatshëm në atë" remb gjyqësor. Drejtuesi i Shërbimeve të Policisë" Gjyqësore në" Policinë Elektrike në" bashkërendim me Prokurorinë organizon grupin hetimor,

6.1 Në rrethet gjyqësore që janë caktuar oficer të policisë elektrike në seksionin e Prokurorisë, grupi hetimor drejtohet nga oficeri i policisë gjyqësore të policisë elektrike në seksionin e Prokurorisë, i cili shkon në vendin e ngjarjes dhe bën këqyrjen e tij.

6.2 Në rrethet gjyqësore që nuk janë caktuar oficer të' policisë elektrike në seksionin « Prokurorisë, grupi hetimor drejtohet nga drejtuesi i shërbimeve të policisë gjyqësore në Policinë Elektrike në atë njësi administrative.

6.3 Oficeri i policisë gjyqësore që drejton kryerjen e veprimeve hetimore në vend ngjarje, se bashku me ekspertin/ët përkatës, përgjigjet për cilësinë dhe saktësinë e këqyrjes së vendit lë' ngjarjes dhe administrimin e provave materiale.

6.4 Në ngjarjet kriminale me pasoja të rënda ose me pasojë vdekje duhet të marrë pjesë prokurori i gatshëm.

7. Pas përfundimit të këqyrjes së vendit të ngjarjes policia gjyqësore vazhdon kryerjen e veprimeve hetimore me iniciativë dhe/ose të urdhëruara apo deleguara nga prokurori.

8. Për ngjarjet kriminale që raund të ndodhin në ambientet e Policisë Elektrike dhe kur subjekte të veprës penale janë punonjës të kësaj policie, shërbimet e policisë gjyqësore të Policisë Elektrike ruajnë vendin e ngjarjes dhe këqyrja e tij, si dhe veprimet e tjera hetimore kryhen nga oficeri i policisë gjyqësore i caktuar nga drejtuesi i Prokurorisë".

7. Drejtuesi i shërbimeve të Policisë Elektrike, për rastet e ngjarjeve kriminale që ka udhëhequr hetimin, në rastet e ndalimit ose arrestimit në flagrancë, njofton menjëherë Prokurorin dhe jo më vonë se 24 orë nga ndalimi ose arrestimi në" flagrancë, dorëzon aktet procedurale në Prokurorinë kompetente, si dhe vazhdon hetimet së bashku me oficerët dhe agentët e policisë gjyqësore, me iniciativë dhe urdhër apo delegim të Prokurorit.

8.1 Dorëzimi në Prokurori dhe marrja nga prokurori i fashikullit të hetimit kryhet nga drejtuesi përkatës i shërbimeve të Policisë Elektrike kundrejt nënshkrimit në regjistrin e Prokurorisë dhe të policisë gjyqësore.

8.2 Fashikulli i procedimit penal mbahet dhe ruhet nga oficeri i policisë gjyqësore të Policisë Elektrike që zhvillon hetimet dhe i vihet në dispozicion prokurorit sa herë që kërkohet prej tij.

9. Oficerët e policisë gjyqësore të Policisë Elektrike të emëruar në seksionin e Prokurorisë, ushtrojnë funksionet e policisë gjyqësore në zyrat e Prokurorisë nën drejtimin dhe kontrollin e Prokurorit. Kur kjo nuk është e mundur, për mungesë të ambienteve të nevojshme, ushtrojnë funksionet në ambiente të Policisë Elektrike të caktuara posaçërisht për ata.

9.1 Oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve, çdo ditë, paraqiten tek drejtuesi i Prokurorisë ose tek personi i autorizuar prej tij, për ta informuar për detyrat e kryera në zbatim të urdhrave/delegimeve dhe probleme të tjera që mund të kenë, si dhe për të marrë detyrat e urdhëruara nga prokurori.

9.2 Oficerët e policisë gjyqësore të seksionit të Prokurorisë hetojnë veprat penale ku procedimi penal ka nisur mbi bazë kallëzimi, vend ngjarje dhe/ose në grupe hetimore të përbashkëta me oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve të Policisë Elektrike.

9.3 Prokuroritë e rretheve gjyqësore detyrohen të pajisin me mjete pune (dosje, formularë, kancelari), oficerët e policisë gjyqësore të Policisë Elektrike, ndërsa drejtuesit e shërbimeve të Policisë Elektrike detyrohen për ti pajisur ata me çdo mjet dhe pajisje tjetër që i takon oficerit të Policisë Elektrike.

9.4 Në raste shërbimi për kryerjen e veprimeve hetimore të urdhëruara nga prokurori, drejtuesit e shërbimeve të Policisë Elektrike detyrohen t'ju vënë në dispozicion automjete dhe t'u paguajnë dietat oficerëve të policisë gjyqësore të Policisë Elektrike në Seksionin e Prokurorisë.

9.5 Fashikujt e hetimeve paraprake që ndjek policia gjyqësore e Policisë Elektrike në Seksionet e Prokurorisë do të jenë të regjistruara në regjistrin e procedimeve penale të Prokurorisë. Ato do të merren me firmë nga oficeri i policisë gjyqësore dhe dorëzimi bëhet me firmë në Sekretarinë e Prokurorisë.

9.6 Në sekretarinë e prokurorisë të mbahet një regjistër i veçantë ku të evidentohen lëvizjet e fashikujve të procedimit nga prokurori tek oficeret e policisë gjyqësore të Policisë Elektrike anasjelltas. Në këtë regjistër të pasqyrohen dhe kalimet e urdhrave dhe delegimeve nga prokurori oficerët e policisë gjyqësore.

10. Pasi kryhen veprimet e nevojshme hetimore, oficerët e policisë gjyqësore të Policisë Elektrike që kanë zhvilluar hetimin dhe/ose drejtuesi i shërbimeve të policisë gjyqësore në Policinë Elektrike, analizojnë procedimin penal tek prokurori që drejton dhe kontrollon hetimet. Në qoftë se konkludohet se hetimet janë kryer të plota, policia gjyqësore i dërgon fashikullin e procedimit penal prokurorit, bashkë me një relacion shpjegues për faktin, provat dhe sugjerimet e veta për mënyrën e përfundimit të hetimeve.

11. Një herë në vit, drejtuesi i Prokurorisë së rrethit gjyqësor dhe drejtuesi i Policisë Elektrike në njësinë administrative përkatëse bëjnë vlerësimin e punës së oficerëve të policisë gjyqësore të Policisë Elektrike në seksionet e Prokurorisë.

12. Jo më pak se një herë në muaj, nën drejtimin e drejtuesit të Prokurorisë së rrethit gjyqësor organizohen takime të përbashkëta me drejtuesit e Policisë Elektrike për të shqyrtua ecurinë dhe problemet që mund të kenë në ushtrimin e funksioneve të policisë gjyqësore në

Policinë Elektrike. Për problemet që dalin dhe nuk marrin zgjidhje në këto takime mbahet procesverbal dhe drejtuesi i Prokurorisë së bashku me drejtuesin e Policisë Elektrike, informojnë Prokurorin e Përgjithshëm dhe Ministrin e Industrisë dhe Energjetikes.

13. Drejtuesit e Prokurorive të rretheve gjyqësore në bashkëpunim me drejtuesit e shërbimeve të policisë gjyqësore në Policinë Elektrike, çdo vit, planifikojnë dhe marrin masa për organizimin, bashkërendimin dhe kryerjen e veprimtarive që kanë për qëllim edukimin dhe trajnimin profesional të oficerëve dhe agentëve të policisë gjyqësore të Policisë Elektrike.


14. Me zbatimin e këtij udhëzimi të përbashkët ngarkohen të gjithë drejtuesit dhe prokurorët në Prokuroritë e shkallës së parë, si dhe drejtuesit dhe oficerët/agentët e Policisë Elektrike të shërbimeve dhe seksioneve. Kontrollon zbatimin e këtij udhëzimi Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtoria e Policisë Elektrike.

18. Moszbatimi i këtij udhëzimi të përbashkët, kur nuk përbën veprë penale, përbën shkelje të rëndë të disiplinës në punë.

Ky udhëzim i përbashkët hyn në fuqi me 31. 03. 2005.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

THEODHORI SOLLAKU



**MINISTRI I INDUSTRIË DHE
ENERGJITIKËS**

VIKTOR DODA

